



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr.96
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303
Prishtinë, më 30 maj 2024, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë : Fatmire Kollçaku, Labinotë Demi- Murtezi, Haxhi Avdyli, Burim Meta, Bekim Haxhiu, dhe Shemsedin Dreshaj, anëtarë.

Munguan: Armend Zemaj, Mirsad Shkreta, Floretë Zejnullahu, dhe Samra Ilijazi, anëtarë.

Pjesëmarrës të ftuar: Fitim Mulolli, ekspert nga Këshilli për Zhvillim te Qëndrueshëm.

Stafi mbështetës : Shpresa Haxhijaj, koordinatore dhe Besim Haliti, zyrtar i lartë/analist.

Pjesëmarrës të tjerë : Shqipe Krasniqi, dhe Violeta Emini – Salihu, zyrtare të larta të Kuvendit të Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi: Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 30.04.2024 ;
3. Vlerësimi i përmbushjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm nga Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare;
4. Të ndryshme.

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 30.04.2024

3.Vlerësimi i përmbushjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm nga Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare

Fatmire Kollçaku: Duke qenë se ne si Kosovë, pas miratimit të rezolutës në vitin 2018 në Kuvendi i Kosovës, jemi zotuar në përmbushjen Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe është krijuar një Këshill Nacional, si organ koordinues, ne që nga ajo kohe si shtet edhe Kuvendi dhe Qeveria, janë zotur në harmonizimin e legjislacionit në harmoni me Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm. Qeveria këtë vit e ka aprovuar një agjendë transformuese, e cila ka për synim katër objektiva; e para është Askush të Mos Lihet Prapa, e dyta fokusi në Edukim, e treta për Energji të Ripërtëritshme dhe katërta, për Digjitalizimi, duke qenë se objektivi i parë që Askush të Mos Lihet Prapa, lidhet shumë më çështjet sociale, që janë në fushëveprimin e komisionit tonë, atëherë po diskutojmë sot, lidhur me vlerësimin e përmbushjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm nga Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare. Sot është i pranishëm eksperti z. Fitim Mulolli, i angazhuar nga Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm, për të e prezantuar raportin e hartuar për Vlerësimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare në raport me përmbushjen e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm, lidhur me Agjendën 2030.

Fitim Mulolli, ekspert nga Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm: Në bazë të Rezolutës për zhvillim të qëndrueshëm të nxjerrë nga Kuvendi i Kosovës, në janar të vitit 2018, është themeluar Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm, në të cilin, kryetarët e komisioneve relevante që lidhen me agjendën 2030, janë anëtarë të Këshillit, ndërsa ky këshill kryesohet nga kryetarja e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, znj. Fatmire Kollçaku, të cilën e falënderoj shumë për mundësinë e bashkëpunimit dhe përgëzoj për mundësinë e lejimit të hartimit të këtij e raporti. Mulolli e paraqiti raportin e Vlerësimit të përmbushjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm nga Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, si në vijim: Kosova është duke i përmbushur qëllimet që lidhen me Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm. Ky vlerësim është bërë, për të konstatuar nivelin e përfshirjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare. Ky ligj i amendamentuar është miratuar nga Kuvendi me 14 dhjetor 2023 dhe është shpallur në Gazetën Zyrtare më 5 janar 2024. Ky është vlerësimi i parë i këtij lloji dhe shërben si model për komisionet parlamentare që të aplikojnë këtë praktikë edhe me ligjet tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, për të konstatuar përfshirjen e OZHQ-ve në legjislacionin e Kosovës. Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare, është esencial për përmbushjen e parimit “Askush të Mos Lihet Prapa”, që përbën një prej parimeve fundamentale të OZHQ-ve dhe Agjendës 2030. Përfshirja e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm; Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, i përfshinë në mënyrë të konsiderueshme Objektivat dhe Targetet përkatëse. Janë katër objektiva kryesore të cilat duhet të përfshihen nga ky ligj: Objektivi 1: Eliminimi i të gjitha formave të varfërisë; Objektivi 2: Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe e përmirësimit të ushqyerjes dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme; Objektivi 3. Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit të çdo moshe; Objektivi 10. Zvogëlimi i pabarazisë brenda çdo vendi dhe ndërmjet shteteve. Brenda këtyre katër objektivave, ligji përmbush 11 caqe. Më së shumti, ligji përmbush pesë (5) Targete të Objektivit 1. Duke marrë parasysh spektrin që mbulon ky ligj është e natyrshme të përfshijë shumicën e Targeteve të Objektivit 1. Këto Targete mbulohen nga një numër i konsiderueshëm i neneve të

ligjit. Më tutje, ky ligj përfshin edhe dy Targete vendimtare të Objektivit 2, që synon eliminimin e urisë. Shërbimet sociale dhe familjare të parapara me këtë ligj, në disa nene parasheh mbështetje dhe ndihmë financiare për fëmijë dhe të rritur në varfëri, duke rezultuar me zvogëlim të urisë në Kosovë. Gjithashtu, ligji përfshin dispozita drejt përmbushjes së Objektivit 3, specifikisht Targeteve 3.5 dhe 3.8. Përmbushja e këtyre dy Targeteve, është që çojnë në sigurimin e mirëqenies sociale të qytetarëve të Kosovës. Ligji parasheh edhe aspektet e arsimimit, duke filluar nga asistenca për qasje të barabartë në arsimim, mbështetja për arsimim në nivel të hershëm të fëmijërisë, sigurimin e gjithëpërfshirës të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuar, dhe të tjera. Edhe pse, arsimimi mbulohet me ligje tjera të veçanta, ky ligj mbulon nga aspekti social dhe i përkrahjes Targetet 4.2, 4.3 dhe 4.5. Dhe në fund, ligji adreson dhe Objektivin 10, Eliminimi i Pabarazive Brenda Çdo Shteti dhe Ndërmjet Shteteve. Dy Targetet kryesore 10.2 dhe 10.4, të cilat çojnë drejt eliminimit të pabarazive në shoqëri, adresohen përgjatë ligjit. Këto dy targete kanë një natyrë të përgjithshme dhe nuk kanë ndonjë fokus specifik, prandaj e gjithë fryma e ligjit aktual çon në përmbushje të këtyre dy Targeteve. Disa prej targeteve të cilat adresohen me këtë ligj janë të natyrës së përgjithshme dhe si të tilla përfshihen në shumë dispozita.

Bekim Haxhiu: Sa i përket Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, Kosova e ka marrë këtë obligim që nga viti 2018, andaj këto obligime duhet të përmbushen nga çdo Qeveri dhe Kuvendi. Ndërsa, lidhur me objektivin parë që ka të bëjë me shërbimet sociale, duhet të shikohet së sa po ofrohen këto shërbime për kategoritë nevojtare, po ashtu, në të ardhmen duhet të monitorohet edhe Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, të shikohet edhe në bazë të ligjit që është në fuqi, se sa po përmbushen këto objektiva. Me qeverinë aktuale ka rritje të varfërisë në Kosovë, pas publikimit të listës së çmimeve të barnave, po vërehet shtrenjtimi i tyre, dhe rritja të çmimit të barnave ndikon drejtpërdrejt edhe në rritjen e varfërisë së qytetarëve.

Haxhi Avdyli: Kjo analizë ka të bëjë me Vlerësimin e përmbushjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm nga Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, sot nuk është temë varfëria e përgjithshme. Sa i përket Qeverisë aktuale në këto tri vite e gjysmë ka treguar se është shumë e interesuar për zvogëlimin e varfërisë dhe se qeveria me vendime direkt me përkrahjen direkt, ka ndikuar në eliminimin e formave të varfërisë, me përkrahje materiale të shtesave për lehonat, me përkrahjen direkt të fëmijëve, pastaj me Superpunën, me përkrahjen e të rinjve, me produkte të veçanta, ka ndikuar drejtpërdrejt në eliminimin e formave të varfërisë, që është objektivi i parë për Zhvillimi të Qëndrueshëm. Meqenëse kolegu Bekim e dha një vështrim për këtë qeveri, jo për këtë raport, ne mund të themi që edhe përkrahja që është bërë përmes subvencioneve, garantëve në bujqësi ka qenë si asnjëherë më parë, dhe kjo ka të bëjë me uljen e varfërisë dhe nxitjen e bujqësisë së qëndrueshme.

Bekim Haxhiu: Lidhur me atë se sa ka punuar qeveria në zvogëlimin e varfërisë, një gjë të tillë, po shihet më shtrenjtimin e energjisë elektrike dhe produkteve të tjera që janë në shportën e konsumatorit dhe se politika e kësaj qeverie është që të varfërojnë qytetarët, duke u rritur çmimet e produkteve bazë, siç është rritur çmimi i rrymës për qytetarët mbi 100 për qind edhe me iu dhanë qytetarëve një here në vit nga 100 euro, nuk është politikë për zhvillim të qëndrueshëm por është lëmshë për qytetarët.

Labinotë Demi- Murtezi: Pajtohem plotësisht, lidhur me Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, që zë vend të rëndësishëm për realizimin e këtyre objektivave, pasi që ka pasur progres

në shumicën e vlerësimit të përmbushjes së targeteve për zhvillimi të qëndrueshëm. Qeveria dihet së ka pasur hapa konkret sa i përket Objektivave tjera, siç është mbështetja financiare për nënat lehona dhe shtesat për fëmijë, pastaj edhe me Superpunën, në përkrahjen e të rinjve, por tek Objektiv 4. Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe nxitja e mundësive për edukim gjatë gjithë jetës për të gjithë, këtu duhet të punojmë për cilësi, sepse ashtu siç e dimë të gjithë, cilësia e arsimit është e ulët, andaj duhet ta ngremë zërin për këtë çështje.

Shemsedin Dreshaj: Sa i përket përmbushjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, mosrritja e pagës minimal është varfëri. Objektiv 2: arritja e sigurisë ushqimore dhe e përmirësimit të ushqyerjes, për sigurinë e ushqimit, këto nuk është bërë mjaftë në mbikëqyrje dhe konsumatorët kanë vërejtjeje në cilësinë e ushqimi. Objektiv 3. Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe, këtu duhet të bëjmë më shumë për sigurimet shëndetësore, kur dihet se e kemi mungesën e sigurimeve shëndetësore për personat e pensionuar. Objektiv 4. Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe nxitja e mundësive për edukim gjatë gjithë jetës për të gjithë, këtu ka vend për një elaborim më të gjatë, sepse te cilësia kemi ngecjen dhe ka problem në edukimin e ulët dhe të mesëm, andaj duhet të gjenden format e edukimit cilësor dhe të vlerësimit, duhet të rekomandohet te edukimi i ulët, mësimi nëpër shkolla të zhvillohet tërëditor, kjo do të ishte forma më e mirë për ta filluar cilësinë në arsim, pasi që kemi problem rreth cilësisë së ulët në arsim, dhe ende nuk ka program mësimor të qartë e ka shumë probleme lidhur me orarin.

Burim Meta: Pajtohem se në shumicën e përmbushjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, ka pasur arritje. Për Objektivin 3. Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe, te Targeti 3.5 që është të forcohet parandalimi dhe trajtimi i personave që abuzojnë me lëndët narkotike dhe me alkoolin. Lidhur më këtë çështje, ka kërkuar edhe në mbledhjet e kaluara që Qeveria të sjellë plotësim ndryshimin i Ligjit për Barnat Narkotike, substancat psikotrope dhe prekursor, pasi që edhe ky ligj ka rëndësi shumë të madhe për qytetarët tonë, ku kemi një rritje enorme të përdoruesve të substancave narkotike, ku përveç kësaj shqetësuese është së po rritet numri fëmijëve dhe i personave që abuzojnë me lëndët narkotike dhe alkoolin.

Fitim Mulloli, ekspert nga Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm: Me këtë raport vetëm e kemi bërë hapin e parë dhe së qëllimi është që gradualisht që deri në vitin 2030, të përmbushen sa më shumë këto objektiva në të gjitha fushat. Edhe Këshilli për zhvillim të qëndrueshëm, si organ koordinues i këtyre objektivave, ka bërë mjaft aktivitete për të parë se ku po qëndron Kosova dhe për t'u munduar të rrisë vetëdijen e institucioneve, së pari, rreth përmbushjes së këtyre objektivave në të gjitha aspektet që duhet të mbulohen nga institucionet e shtetit, në këtë rast Kosova më anë të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, me mjaft sukses përmbush 11 Targete.

Fatmire Kollçaku: Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm, për herë të parë e ka hartuar një raport të tillë dhe si këshill do të vazhdojmë të punojmë në përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në bazë të agjendës 2030, dhe pse fushëveprimi i objektivave është mjaft i gjerë dhe Këshilli, si organ koordinues i këtyre objektivave, ka qenë në kontakte të vazhdueshme edhe

me Komisionet e tjera parlamentare dhe do ta vazhdojë punën me të gjitha grupet e interesit, që të jenë në dijeni për të gjithë problemet e tyre.

4.Të ndryshme.

Fatmire Kollçaku: Propozoj organizimin e Tryezës më datën 10 qershor 2024 më rastin e shënimit të themelimit të Instituti Kombëtar të Shëndetit Publik, më temën “99 – Vite funksionim të Instituti Kombëtar të Shëndetit Publik”.

Me këtë propozim të znj. Kollçaku, u pajtua Komisioni.

Bekim Haxhiu: Propozoj që lidhur më miratimin e Listës zyrtare të çmimit të produkteve medicinale, e cila është publikuar nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, të ftohet në mbledhjen e radhës, Komisioni për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale, që është themeluar nga Ministri i Shëndetësisë, i cili ka miratuar këtë listë, Ai potencoi se Ligjin për çmimin e produkteve medicinale të cilin ne e kemi votuar në Kuvend, që ka të bëjë më rregullimin e çmimeve të produkteve medicinale, qëllimi dhe synimi i të gjithëve ka qenë, që me këtë ligj të ulen çmimet e barnave dhe të ketë një unifikim të çmimit të barnave në nivelin e Republikës së Kosovës. Mirëpo, jam i zhgënjyer me atë që kam parë pas publikimit të listës së çmimeve të barnave, nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, ku barnat të cilat sot janë në treg me pakicë, në listën e çmimeve dalin shumë më shtrenjtë sesa që janë në treg me shumicë.

Burim Meta: Është shqetësuese nëse është miratuar në këtë formë Lista zyrtare e çmimit të produkteve medicinale nga Komisioni për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale. Qëllimi i miratimit të Ligjit për çmimin e produkteve medicinale, ka qenë që të unifikohen çmimet e barnave dhe më këtë listë paska rritje e jo ulje, pajtohem që të ftohen palët për të na sqaruar.

Haxhi Avdyli: Sa i përket Listës zyrtare të çmimit të produkteve medicinale, besoj së është lista e çmimeve tavan, por sidoqoftë pajtohem që të ftohen palët dhe të sqarohet kjo listë, kërkoj që të ftohet edhe kryeshefi ekzekutiv nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, për këtë çështje.

Shemsedin Dreshaj: Kërkoj përpos Komisionit për përcaktimin e çmimeve për produkte medicinale dhe të kryeshefit ekzekutiv të AKPPM-së, të ftohet edhe kryetari i Odës së Farmacistëve të Kosovës.

Fatmire Kollçaku: Meqenëse ka pajtim për këtë propozim, atëherë propozoj që mbledhja e radhës të mbahet më 10 qershor 2024, në orën 12:00, me temën : Diskutim për Listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Fatmire Kollçaku,

Kryetare e Komisionit
